

VENDIM

Nr. 722, datë 11.11.2019

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS, TË KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR VLERËSIMIN DHE PËRFITIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR E TË NDIHMËSIT PERSONAL, DHE TË STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE E TË DETYRAVE TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të nenit 30, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. OBJEKTI DHE SUBJEKTET PËRFITUESE

1. Modeli biopsikosocial i vlerësimit të aftësisë së kufizuar do të zbatohet në qarqet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, afateve të përcaktuara në vendimin nr. 380, datë 5.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit politik ‘Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij’”, dhe nëpërmjet përdorimit të Regjistrisë Elektronike Kombëtare.

2. Në vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar do të përfshihen individët, që:

- a) kërkojnë të vlerësohen për herë të parë;
- b) kërkojnë të rivlerësohen, të cilët kanë përfituar pagesë të aftësisë së kufizuar sipas legjislacionit në fuqi.

II. KRITERET E PËRFITIMIT DHE DOKUMENTACIONI I PRANIMIT

1. Për marrjen e përfitimeve të aftësisë së kufizuar duhet të plotësohen kriteret, si më poshtë vijojnë:

a) personi duhet të ketë një gjendje mjekësore të vërtetuar të një dëmtimi fizik, mendor, intelektual apo ndijor të lehtë, mesatar, të rëndë ose të thellë;

b) duhet të vërtetohen kufizime të lehta, mesatare, të rënda ose të thella, të shkaktuara nga dëmtimi;

c) duhet të vërtetohen kufizime mesatare, të rënda, të thella për të kryer veprimtari domethënëse të jetesës së përditshme, të përshtatshme për moshën e personit dhe për të marrë pjesë në jetën shoqërore, ekonomike e politike;

ç) personi duhet të përjetojë kufizime të konsiderueshme mjedisore dhe të qëndrimit, të cilat ndikojnë në aftësinë për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri;

d) personi duhet të jetë i paaftë për punë dhe të mos plotësojë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;

dh) personit duhet të mos i ketë lindur e drejta për përfitim të pensionit të pleqërisë/social sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

2. Dokumentacioni për përfitimin e aftësisë së kufizuar përfshin:

- a) formularin e aplikimit, sipas formatit 1 bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) formularin e plotësuar nga mjeku i familjes, sipas formatit 2, për të rritur, ose sipas formatit 3, për fëmijë, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) formularin e plotësuar nga mjeku specialist i qendrave shëndetësore të specialiteteve apo të spitaleve, kur nuk mbulohet nga qendrat shëndetësore, sipas formatit 4, për të rritur, ose sipas formatit 5, për fëmijë, bashkëlidhur këtij vendimi. Për sëmundjet e shëndetit mendor ky formular plotësohet nga Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (QKSHM). Për fëmijët, formulari mund të plotësohet edhe nga Qendra Kombëtare e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve (QKMZHRF);

ç) kopjen e letërnjoftimit/certifikatës personale me fotografi.

3. Dokumentet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, dorëzohen/postohen pranë zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

III. VLERËSIMI BIOPSIKOSOCIAL

1. Procesi i mbështetur në modelin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar përfshin vlerësimin mjekësor të aplikuesit nga mjeku i familjes dhe nga mjeku specialist/QKSHM-ja, një intervistë me aplikuesin në zyrën e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar me mjekë dhe punonjës socialë, verifikimin e informacionit të marrë dhe kontrollin vjetor mjekësor.

2. Vlerësimi biopsikosocial i aftësisë së kufizuar dhe i nivelit të kufizimeve funksionale bëhet në përputhje me Klasifikimin Ndërkombëtar mbi Funksionimin, Aftësinë e Kufizuar dhe Shëndetin të Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ky vlerësim përfshin faktorët që dëmtojnë aftësinë e një individi për të kryer veprimtari të jetesës së përditshme dhe për të marrë pjesë në shoqëri në kushte të barabarta me të tjerët, në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin biopsikosocial të aftësisë së kufizuar për të rriturit dhe fëmijët, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe për shëndetësinë.

3. Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

4. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror krijohen komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të cilat funksionojnë në nivel rajonal, që përbëhen nga punonjës me kohë të plotë dhe kanë në përbërje, së paku, një mjek dhe një punonjës social për çdo komision, të trajnuar për modelin biopsikosocial të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara. Çdo komision asistohet nga një punonjës, i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit. Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Stafi i zyrës së vlerësimit kryen këto detyra:

- a) hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat e aplikuesit;
- b) vlerëson dhe shqyrton dosjet e paraqitura për vlerësim/rivlerësim;
- c) verifikon dhe shkëmben informacionin elektronik me rrjetin e institucioneve të tjera të kujdesit shëndetësor, të arsimit, punësimit e formimit profesional, të sigurimeve shoqërore, tatimeve, strukturave përgjegjëse pranë pushtetit vendor, si dhe institucioneve të tjera, nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar dhe, kur nuk është e mundur, manualisht/zyrtarisht;
- ç) cakton datën e intervistës dhe njofton zyrtarisht kërkuesit, nëpërmjet administratorit shoqëror ose kthen zyrtarisht dosjen për plotësim, kur ka mungesë dokumentacioni, në njësinë administrative;
- d) organizon kryerjen e intervistës, sipas formatit 6, bashkëlidhur këtij vendimi, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së dokumenteve të aplikimit;
- dh) bën vlerësimin për përcaktimin e nevojës për ndihmës personal;
- e) përcakton nivelin e përgjithshëm të aftësisë së kufizuar;
- ë) bën përgatitjen e rekomandimeve për shërbime të tjera dhe marrjen e vendimit për përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar;
- f) lëshon dokumentin që vërteton aftësinë e kufizuar, sipas formatit 7, bashkëlidhur këtij vendimi;
- g) shqyrton të dhënat e kontroleve periodike të nevojshme, të kryera sipas formatit 8, bashkëlidhur këtij vendimi;
- gj) mban, ruan dhe përditëson të dhënat e dokumentacionit të kërkuesve e të përfituesve të aftësisë së kufizuar, elektronikisht dhe fizikisht;
- h) adreson fëmijët e moshës shkollore pranë institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, për vlerësimin e nevojave të tyre arsimore.

5. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar, njofton zyrtarisht aplikuesin për vendimmarrjen dhe e pajis me dokumentin përkatës, që përcakton aftësinë e kufizuar. Vendimi për përfitimet e aftësisë së kufizuar dhe të ndihmës personal i përcillet bashkisë, për:

- a) zbatimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të lëna nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit;
- b) kryerjen e veprimeve financiare për dhënien e pagesës për përfituesit e aftësisë së kufizuar.

6. Administratori shoqëror pranë organeve të pushtetit vendor, lidhur me menaxhimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara, ka përgjegjësi për:

- a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e

komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;

- b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individi, jo më pak se një herë në tre muaj;
 - c) informimin e zyrës së vlerësimit për ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;
 - ç) informimin e individëve për shërbimet shoqërore ekzistuese nën juridiksionin e bashkisë/njesisë administrative, në territorin e së cilës është banor individi;
 - d) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;
 - dh) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;
 - e) informimin e familjarëve për të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t'u arsimuar;
 - ë) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;
 - f) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës;
 - g) evidentimin dhe verifikimin e rasteve të personave që përfitojnë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, informimin e strukturave përgjegjëse të shërbimit social shtetëror për të kryer verifikimet me institucione të tjera, si dhe për vendndodhjen e tyre, kur ka dijeni;
 - gj) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, me përjashtim të personave e të familjeve të tyre të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organizmave ndërkombëtarë;
 - h) ndërprerjen e pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë jashtë vendit për më shumë se 3 muaj, si dhe të rasteve të përfituesve, të cilët ndodhen jashtë shtetit shqiptar për qëllime kurimi apo rehabilitimi;
 - i) informimin dhe udhëzimin në komunitetet lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;
 - j) bashkëpunimin me punonjësit socialë, që janë pjesë e strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror dhe/ose njesisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar, sipas përcaktimeve në nenin 36, të ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
 - k) adresimin e rasteve të personave me aftësi të kufizuara drejt programeve të tjera sociale, shëndetësore, të arsimit e formimit profesional dhe të punësimit, me qëllim rehabilitimin dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore, në përputhje edhe me rekomandimet e komisionit.
7. Monitorimi i punës së zyrave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në bazë të metodologjisë së kontrollit të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe shëndetësinë.

IV. PËRFITIMET NË PAGESA DHE SHËRBIME

1. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore, që jepet në muajin pasardhës, nga data e vendimit për përfitime, me qëllim përmbushjen e nevojave elementare të lidhura me aftësinë e kufizuar, e cila përfitohet nga personat që janë deklaruar si të tillë me vendim të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.
2. Pagesa bazë për shkak të aftësisë së kufizuar për të rritur dhe fëmijë është 150% e shumës së pensionit social, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
3. Pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar për të rritur dhe fëmijë janë sipas përcaktimeve në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç", të kreut IV, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot", të ndryshuar.
4. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar indeksohet nga Shërbimi Social Shtetëror sa herë indeksohet pensioni social dhe në bazë të këtij indeksi.
5. Përfituesit e aftësisë së kufizuar, të cilët vlerësohen se kanë nevojë për paketë higjieno-sanitare, përfitojnë një pagesë shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës higjieno-sanitare, në masën e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
6. Niveli i aftësisë së kufizuar dhe përfitimet përcaktohen bazuar në vlerësimin biopsikosocial, të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.
7. Pagesat për personat me aftësi të kufizuara kryhen nëpërmjet shërbimeve bankare ose

Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.

8. Personat me aftësi të kufizuara, që ndjekin një kurs kualifikimi të licencuar ose të akredituar dhe nxënësit, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë, përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin kursin/shkollën vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/programit të studimit.

9. Studentët, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit. E njëjta masë pagese zbatohet për personat që ndjekin programin e studimit të ciklit të tretë. Për personat që ndjekin studimet e doktoratës dhe për personat që ndjekin procedurat për fitimin e një titulli akademik, kjo pagesë përfitohet në mënyrë të përhershme, mbi bazën e dëshmisë së lëshuar nga organet kompetente për fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

10. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin njëkohësisht arsimin e mesëm të lartë apo arsimin e lartë dhe një kurs kualifikimi, përfitojnë vetëm njërën nga pagesat.

11. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët ndjekin arsimin e mesëm të lartë apo të lartë, paraqesin për çdo fillim të vitit shkollor/akademik dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetimin e nënshkruar nga titullari dhe sekretari i institucionit arsimor të mesëm të lartë dhe të lartë, ku shënohet emri dhe mbiemri i personit, niveli i arsimit që ndjek, viti shkollor/akademik dhe kohëzgjatja. Për të vërtetuar frekuentimin e procesit mësimor vërtetimi lëshohet çdo tre muaj. Vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve të çdo sezoni lëshohet vetëm për personat që ndjekin arsimin e lartë;

b) kopjen e noterizuar të dëftesës së çdo viti, kopjen e noterizuar të diplomës në mbarim të shkollës së mesme të lartë apo të lartë dhe/ose kopje të dëshmisë së kursit të kualifikimit.

12. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë fituar gradë shkencore/titull akademik, paraqesin kopjen e noterizuar të dokumentit që vërteton fitimin e gradës shkencore/titullit akademik.

13. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror ose rajonal, ka të drejtë të verifikojë me strukturat përgjegjëse për çështjet e arsimit, vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga ana e institucioneve arsimore.

14. Personat me aftësi të kufizuara me kufizime të rënda apo të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmës personal, kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

15. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmës personal përcaktohet në bazë të vlerësimit biopsikosocial të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.

16. Pagesat për shërbime të ndihmës personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksimit të pensionit social.

17. Pagesat për shërbime të ndihmës personal u referohen pagesave të përcaktuara në pikat 16 dhe 17, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

18. Ndihmës personalë, që ofrojnë këtë shërbim për më shumë se një përfitues, marrin një shtesë prej 50% të shumave përkatëse për çdo përfitues të shtuar.

19. Pagesat për shërbime të ndihmës personal jepen në muajin pasardhës, pas vendimit të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit. Pagesa kryhet nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi.

V. PROCEDURA E ANKIMIMIT

1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni.

2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nuk u nënshtrohen procedurës së vlerësimit, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi:

a) të verbrit përfitues ose aplikues, që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbrit;

b) paraplegjikët dhe tetraplegjikët përfitues ose aplikues, që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik.

2. Shërbimi Social Shtetëror miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e komisioneve shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel qendror e rajonal dhe protokollin e punës së tyre.

3. Shkronjat “d”, “dh”, “e” dhe “ë”, të kreut IV, dhe çdo përcaktim i vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, të ndryshuar, të cilat bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

4. Ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore shëndetësore e sociale dhe organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në të cilat zbatohet kjo skemë vlerësimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



FORMULAR APLIKIMI
VLERËSIMI I PËRCAKTIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +355 4 2376 178 E-mail: info@shendetesia.gov.al Web: www.shendetesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKANTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. E-mail	<input type="text"/>	15. Nr. Sig Shëndetësor	<input type="text"/>

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

1. A keni aplikuar më parë për të marrë përfitime të aftësisë së kufizuar? Po Jo

2. A keni marrë përfitime të aftësisë së kufizuar më parë? Po Jo

3. Në cilën kategori bëni pjesë? (zgjidh vetëm një mundësi, më të përshtatshmen për rastin tuaj)

Mbi moshën 18 vjeç

I/e punësuar I/e vetëpunësuar I/e papunë Student

Shtëpiak/e Pensionist/e Qendër ditore Tjetër (specifiko)

Nën moshën 18 vjeç

Çerdhe Kopsht Nxënës Shtëpi

Tjetër (specifiko)

4. Historiku i punësimit (nëse është i aplikueshëm)

	nga	deri më
<input type="text"/>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
<input type="text"/>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
<input type="text"/>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>	<input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>

faqe 1/2

Ky formular është standardizuar nga ADISA

AL115003-317



5. Arsimi

- Pa arsim Fillor 9-vjeçar I mesëm I lartë

Numri i viteve të plotësuara

6. A keni pasur ndonjëherë përfitime nga Sigurimet Shoqërore?

- Po Jo

7. Nëse po, çfarë lloj përfitimi?

- Aftësi e kufizuar Pension pleqërie Tjetër (specifiko)

8. Përfitimet e aftësisë së kufizuar, për të cilat po aplikoni

- Teknologji ndihmëse/Karrige me rrota Përfitime financiare Ndihmës personal
 Përfitimi i arsimit Përkthyes i gjuhës së shenjave Telefon
 Paketë higjieno-sanitare Udhëtimi me autobus

9. A kërkonti vizitë mjekësore dhe intervistë në shtëpi?

(vetëm në rastet kur kërkuesi nuk mund të lëvizë nga vendbanimi i tij/saj për shkak të nevojave të tij/saj mjekësore ose barrierat e rënda të aksesueshmërisë)

- Po Jo

10. Mënyra e kontaktimit

- Postë elektronike (e-mail)
 Telefon
 Postë
 Nëpërmjet administratorit social të bashkisë

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR

- Certifikatë personale lindje me një fotografi të bërë gjashtë muajt e fundit (për aplikantët nën 16 vjeç)
 Fotokopje e letërnjoftimit
 Formulari i plotësuar nga mjeku i familjes/pediatri (brenda muajit të fundit)
 Formulari i plotësuar nga mjeku specialist/Qendra Komunitare e Shëndetit Mendor (brenda muajit të fundit)
 Formulari i plotësuar nga qendra e shërbimeve (nëse aplikohet)

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

- Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i aplikantit

Data			Muaji			Viti			

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data			Muaji			Viti			



FORMULAR APLIKIMI
VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
NGA MJEKU I PËRGJITHSHËM
 (FORMULAR PËR TË RRITUR)
 SHËRBIMI SOCIAL SHTETËTOR
 MINISTRIA E SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +355 4 2376 178 E-mail: info@shendetesia.gov.al Web: www.shendetesia.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN
Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI PACIENTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <input type="text"/> <i>Data Muaji Viti</i>
7. Vendlindja	<input type="text"/>		
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. E-mail	<input type="text"/>	15. Nr. Sig shëndetësor	<input type="text"/>

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Numri i licencës	<input type="text"/>	4. Specialiteti	<input type="text"/>
5. Adresa	<input type="text"/>		
6. Qyteti	<input type="text"/>	7. Rrethi	<input type="text"/>
8. Kodi Postar	<input type="text"/>	9. Nr. Tel	<input type="text"/>
10. E-mail	<input type="text"/>		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme në lidhje me aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore mbi kërkesën për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar dhe si rekomandim për vizitën tek mjeku specialist për këtë qëllim.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni pacientin për rekomandim të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar?

Po **Jo**

2. Kohëzgjatja e trajtimit të pacientit

3. Numri i trajtimeve të pacientit në 12 muajt e fundit

4. Diagnoza kryesore e pacientit sipas emërimit në udhëzuesin Bio-Psiko-Social

Data e shfaqjes (Viti)

5. Diagnoza të tjera (nëse ka)

Data e shfaqjes (Viti)

Data e shfaqjes (Viti)									
Data e shfaqjes (Viti)									

6. Duke u bazuar në diagnozën e fundit/diagnozat që shënuat më sipër, shënoni funksionet trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore si edhe shkallën e dëmtimit, duke vënë numrin e duhur sipas shkallës së mëposhtme:

- 0 Asnjë dëmtim**, do të thotë që personi nuk ka problem (0-5%)
- 1 Dëmtim i lehtë**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm në më pak se 35% të kohës, me një intensitet që personi mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (6-35%)
- 2 Dëmtim i moderuar**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm në më shumë se 35% të kohës, por më pak se 50% të kohës, me një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të individit dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)
- 3 Dëmtim i rëndë**, do të thotë që një problem i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, por më pak se 90%, ose ka një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të personit dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)
- 4 Dëmtim i plotë**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm për më tepër se 95% të kohës, ose ka një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të pacientit dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)
- 8 Jo specifikuar**, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar ashpërsinë e dëmtimit

Shkalla e dëmtimit
0 1 2 3 4 8

FUNKSIONET MENDORE (b1)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET NDIJORE DHE DHIMBJA (b2)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET E ZËRIT DHE LIGJËRIMIT (b3)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR, HEMATOLOGJIK, IMUNOLOGJIK DHE TË FRYMËMARRJES (b4)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET E SISTEMEVE TË TRETJES, METABOLIZMIT DHE GJËNDRAVE ENDOKRINE (b5)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET GJENITOURINARE DHE TË RIPRODHIMIT (b6)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET NEURO-MUSKULO-SKELETORË DHE ATO TË LIDHURA ME LËVIZJEN (b7)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
FUNKSIONET E LËKURËS DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TO (b8)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
ÇDO FUNKSION TJETËR TRUPOR QË NUK PËRFSHIHET MË SIPËR (b9)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

(specifiko dhe përshkruaj)

7. Strukturat trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkalla e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme:

A: Shkalla e dëmtimit

- 0 - Asnjë dëmtim (0-5%)
- 1 - Dëmtim i lehtë (6-35%)
- 2 - Dëmtim mesatar (36-50%)
- 3 - Dëmtim i rëndë (51-90%)
- 4 - Dëmtim i plotë/i thellë (91-100%)

B. Lloji i ndryshimit

- 0 - Asnjë ndryshim në strukturë
- 1 - Mungesë totale
- 2 - Mungesë e pjesshme
- 3 - Pjesë të shtuara
- 4 - Dimensione anormale
- 5 - Ndërprerje
- 6 - Pozicion i devijuar
- 7 - Ndryshime cilësore në strukturë, përfshirë akumulimin e lëngjeve
- 8 - Të paspecifikuara
- 9 - Të paaplikueshme

C: Vendi i dëmtimit

- 0 - Më shumë se një zonë
- 1 - Djathtas
- 2 - Majtas
- 3 - Të dyja anët
- 4 - Përpara
- 5 - Prapa
- 6 - Proksimal
- 7 - Skajor
- 8 - E paspecifikuar
- 9 - E paaplikueshme

Kategoritë e Strukturave trupore vijnë si më poshtë. Ju lutem, plotësoni vetëm kur është e zbatueshme.

	Shkalla e dëmtimit	Natyra e ndryshimit	Vendi i dëmtimit
STRUKTURAT E SISTEMIT NERVOR (s1)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
SYRI, VESHI DHE STRUKTURAT E TJERA TË LIDHURA ME TO (s2)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT, PËRFSHIRË ATO NË ZË DHE LIGJËRIM (s3)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E SISTEMEVE KARDIOVASKULARE, IMUNOLOGJIKE DHE RESPIRATORE (s4)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET E TRETJES, METABOLIZMIT DHE ENDOKRINALE (s5)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET GJENITALE DHE TË RIPRODHIMIT (s6)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME LËVIZJEN (s7)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
LËKURA DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (s8)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
ÇDO STRUKTURË TJETËR TRUPORE QË NUK ËSHTË PËRFSHIRË MË SIPËR (s9)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

(specifiko dhe përshkruaj dëmtimin)

8. Duke mbajtur në vëmendje shkallën e dëmtimeve të funksioneve dhe strukturave trupore që vinë nga të gjitha diagnozat që keni shënuar më sipër, sipas mendimit tuaj profesional, plotësoni sa është shkalla e vështirësive që has pacienti pa mbështetje për të realizuar veprimtarinë bazë të jetës, të tilla si kujdesi për veten dhe kryerja e nevojave bazë, marrëdhënia me të tjerët, realizimi i shkollimit, i formimit profesional, apo punësimit si dhe pjesëmarrja në veprimtari shoqërore, kulturore, artistike, sportive etj., në përputhje me moshën dhe dëshirën.

Përdorni shkallën e mëposhtme për ta përcaktuar.

- 0 Aspak vështirësi**, do të thotë se personi nuk has ndonjë problem në realizimin e aktivitetit. (p.sh. në rastin e komunikimit me gojë, personi përdor shumë mirë gjuhën shqipe në përputhje me moshën).
- 1 Vështirësi e lehtë/pak vështirësi**, do të thotë se personi has pak vështirësi herë pas here, por këto vështirësi nuk e bëjnë të pamundur kryerjen e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësie shkakton vetëm kufizime të vogla në pjesëmarrje që nuk janë të ndjeshme në cilësinë e jetës së personit. (p.sh. personit i mbahet goja kur flet, por kjo nuk krijon pengesa në komunikim me të tjerët).
- 2 Vështirësi e moderuar**, do të thotë që personi has disa pengesa në realizimin e veprimit, por këto pengesa nuk e bëjnë të pamundur kryerjen e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësie shkakton kufizime të konsiderueshme në pjesëmarrje që janë të ndjeshme në cilësinë e jetës së personit. (p.sh. personi ka një fjalor të kufizuar dhe përdor fjali të thjeshta në komunikim).
- 3 Vështirësi e rëndë/shumë vështirësi** do të thotë që personi has shumë vështirësi në realizimin e veprimit në masë të tillë që në shumicën e rasteve e ka pothuaj të pamundur realizimin e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësie shkakton kufizime të mëdha në pjesëmarrje që ndikojnë në shkëputjen e pjesshme të personit nga jeta e përditshme. (p.sh. personi mund të kuptojë fjalë e shprehje nga gjuha e folur dhe mund të thotë disa fjalë apo dhe ndonjë fjali, por e ka të pamundur të shprehë mendimet).
- 4 Vështirësi e thellë/e plotë**, do të thotë që personi has vështirësi të tilla që nuk e lejon në asnjë mënyrë realizimin e veprimit. Kjo shkallë vështirësie e shkëput plotësisht personin nga jeta e përditshme dhe pjesëmarrja (p.sh. personi mund të kuptojë ndonjë fjalë, por nuk shprehet dot).

KUFIZIMET NË AKTIVITETE DHE PJESËMARRJE

Niveli i vështirësive

0 1 2 3 4

9. A ka ndonjë faktor tjetër, i cili nuk është adresuar në pyetjet më lart, për të cilin ju besoni që mund të ndikojë në aftësinë e pacientit për të funksionuar normalisht në jetën e përditshme, në përputhje me kërkesat e moshës?

Po Jo

(Nëse po, shpjegoni)

10. Duke u bazuar në mendimin tuaj profesional si edhe analizat, testet etj., që ka kryer personi dhe që janë të dokumentuara në dosjen e tij/saj në klinikën tuaj, a e rekomandoni këtë person për të marrë mendimin e mjekut specialist për përfitimin e aftësisë së kufizuar?

Po Jo

11. Cilin specialitet rekomandoni (p.sh.mjeku neurolog,etj.)?

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.

Nënshkrimi i aplikantit/
Kujdestari ligjor

Data

Data		Muaji			Viti		

Nënshkrimi i mjekut

Data

Data		Muaji			Viti		



FORMULAR APLIKIMI
VLERËSIMI MJEKËSOR PËR PËRCAKTIMIN E AFTËSISË SË KUFIZUAR
NGA MJEKU I PËRGJITHSHËM
FORMULAR PËR FËMIJËT (MOSHA 2-18 VJEÇ)
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE



<p>Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Tel: +355 4 2376 178 E-mail: info@shendetesia.gov.al Web: www.shendetesia.gov.al</p>	<p>HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN</p>
<p>Shënim: Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</p>	

SEKSIONI A: INFORMACION SPECIFIK MBI PACIENTIN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Emri i Babait	<input type="text"/>	4. NID <i>Nr. i identifikimit personal</i>	<input type="text"/>
5. Gjinia	<input type="checkbox"/> Mashkull <input type="checkbox"/> Femër	6. Datëlindja	<input type="text"/> <small>Data</small> <input type="text"/> <small>Muaji</small> <input type="text"/> <small>Viti</small>
7. Vendlindja	<input type="text"/>	8. Shtetësia	<input type="text"/>
9. Adresa	<input type="text"/>		
10. Qyteti	<input type="text"/>	11. Rrethi	<input type="text"/>
12. Kodi Postar	<input type="text"/>	13. Nr. Tel	<input type="text"/>
14. E-mail	<input type="text"/>	15. Nr. Sig shëndetësor	<input type="text"/>

SEKSIONI A1: INFORMACION SPECIFIK MBI MJEKUN

1. Emri	<input type="text"/>	2. Mbiemri	<input type="text"/>
3. Numri i licencës	<input type="text"/>	4. Specialiteti	<input type="text"/>
5. Adresa	<input type="text"/>		
6. Qyteti	<input type="text"/>	7. Rrethi	<input type="text"/>
8. Kodi Postar	<input type="text"/>	9. Nr. Tel	<input type="text"/>
10. E-mail	<input type="text"/>		

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

Plotësoni fushat e mëposhtme në lidhje me aftësinë e kufizuar të pacientit tuaj. Informacioni do të përdoret si evidencë mjekësore mbi kërkesën për përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar. Specifikoni gjendjen mjekësore të pacientit dhe si ajo ndikon në aktivitetet e jetës së përditshme në përputhje me moshatarët.

1. A është kjo hera e parë që ju e vizitoni fëmijën për rekomandim të përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar?
 Po Jo

2. Nëse po, cila është kohëzgjatja e trajtimit të pacientit (në vite)

3. Numri i trajtimeve të fëmijës në 12 muajt e fundit

4. Diagnoza kryesore e pacientit. Shënoni emërtimin për diagnozën që përkon me emërtimin në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

Data e shfaqjes (Viti)

5. Diagnoza të tjera (nëse ka). Shënoni emërtimin për diagnozën që përkon me emërtimin në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social.

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Data e shfaqjes (Viti)

6. Bazuar në diagnozën/diagnozat që shënuat më sipër, shënoni funksionet trupore që janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, si dhe shkallën e dëmtimit me numrin përkatës, referuar renditjes së mëposhtme:

- 0 Asnjë dëmtim**, do të thotë që fëmija nuk ka problem (0-5%)
- 1 Dëmtim i lehtë**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm në më pak se 35% të kohës, ose ka një intensitet që fëmija mund të tolerojë dhe që ndodh rrallë përgjatë 30 ditëve të fundit (6-35%)
- 2 Dëmtim i moderuar**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm në më shumë se 35% të kohës, por më pak se 50% të kohës, ose ka një intensitet, i cili ndikon në jetën e përditshme të fëmijës dhe që ndodh me raste përgjatë 30 ditëve të fundit (36-50%)
- 3 Dëmtim i rëndë**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm për më shumë se 50% të kohës, ose ka një intensitet, i cili në mënyrë të pjesshme prish jetesën e përditshme të fëmijës dhe ndodh në mënyrë të vazhdueshme përgjatë 30 ditëve të fundit (51-90%)
- 4 Dëmtim i plotë**, do të thotë që problemi i shkaktuar nga dëmtimi është i pranishëm për më tepër se 95% të kohës, ose ka një intensitet që shkatërron në mënyrë totale jetesën e përditshme të fëmijës dhe që ndodh çdo ditë përgjatë 30 ditëve të fundit (91-100%)
- 8 Jo i specifikuar**, do të thotë që nuk ka informacion të mjaftueshëm për të specifikuar nivelin e dëmtimit

KATEGORITË E FUNKSIONEVE TRUPORE

7. Plotësoni vetëm kur është e zbatueshme.

	Shkalla e dëmtimit
	0 1 2 3 4 8
FUNKSIONET MENDORE (b1)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET NDIJORE DHE DHIMBJA (b2)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET E ZËRIT DHE LIGJËRIMIT (b3)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET E SISTEMIT KARDIOVASKULAR, HEMATOLOGJIK, IMUNOLOGJIK DHE TË FRYMËMARRJES (b4)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET E SISTEMEVE TË TRETJES, METABOLIZMIT DHE GJËNDRAVE ENDOKRINE (b5)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET GJENITOURINARE DHE TË RIPRODHIMIT (b6)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET NEURO-MUSKULO-SKELETORË DHE ATO TË LIDHURA ME LËVIZJEN (b7)	□ □ □ □ □ □
FUNKSIONET E LËKURËS DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (b8)	□ □ □ □ □ □
ÇDO FUNKSION TJETËR TRUPOR QË NUK PËRFSHIHET MË SIPËR (b9)	□ □ □ □ □ □

8. Shënoni strukturat trupore, që në mënyrë domethënëse, janë dëmtuar si rezultat i gjendjes shëndetësore, duke vendosur numrin e duhur, referuar renditjes së mëposhtme:

A: Shkalla e dëmtimit

- 0 - Asnjë dëmtim (0-5%)
- 1 - Dëmtim i lehtë (6-35%)
- 2 - Dëmtim mesatar (36-50%)
- 3 - Dëmtim i rëndë (51-90%)
- 4 - Dëmtim i plotë/i thellë (91-100%)

B: Lloji i ndryshimit

- 0 - Asnjë ndryshim në strukturë
- 1 - Mungesë totale
- 2 - Mungesë e pjesshme
- 3 - Pjesë të shtuara
- 4 - Dimensione anormale
- 5 - Ndërprerje
- 6 - Pozicion i devijuar
- 7 - Ndryshime cilësore në strukturë, përfshirë akumulimin e lëngjeve
- 8 - Të paspecifikuara
- 9 - Të paaplikueshme

C: Vendi i dëmtimit

- 0 - Më shumë se një zonë
- 1 - Djathtas
- 2 - Majtas
- 3 - Të dyja anët
- 4 - Përpara
- 5 - Prapa
- 6 - Proksimal
- 7 - Skajor
- 8 - E paspecifikuar
- 9 - E paaplikueshme

KATEGORITË E STRUKTURAVE TRUPORE

9. Plotësoni vetëm kur është e zbatueshme.

	Shkalla e dëmtimit	Lloji i ndryshimit	Vendi i dëmtimit
STRUKTURAT E SISTEMIT NERVOR (s1)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
SYRI, VESHI DHE STRUKTURAT E TJERA TË LIDHURA ME TO (s2)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT, PËRFSHIRË ATO NË ZË DHE LIGJËRIM (s3)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E SISTEMEVE KARDIOVASKULARE, IMUNOLOGJIKE DHE RESPIRATORE (s4)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET E TRETJES, METABOLIZMIT DHE ENDOKRINALE (s5)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME SISTEMET GJENITALE DHE TË RIPRODHIMIT (s6)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
STRUKTURAT E LIDHURA ME LËVIZJEN (s7)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
LËKURA DHE STRUKTURAT E LIDHURA ME TË (s8)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
ÇDO STRUKTURË TJETËR TRUPORE QË NUK ËSHTË PËRFSHIRË MË SIPËR (s9)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

10. Duke mbajtur parasysh shkallën e dëmtimeve të funksioneve dhe strukturave trupore që vijnë nga të gjitha diagnozat që keniz shënuar më sipër, sipas mendimit tuaj profesional, sa është shkalla e vështirësive që has fëmija, për të realizuar pa mbështetje veprimtaritë bazë të jetës, si të folurit, lëvizja, kujdesi për veten dhe kryerja e nevojave bazë, marrëdhënia me të tjerët, realizimi i shkollimit, si edhe pjesëmarrja në veprimtari shoqërore, kulturore, artistike, sportive, etj., në përputhje me moshën dhe dëshirën. Përdorni shkallën e mëposhtme për ta përcaktuar.

- 0 Aspak vështirësi** do të thotë se fëmija nuk has ndonjë problem në realizimin e aktivitetit. (p.sh. në rastin e komunikimit me gojë, fëmija përdor shumë mirë gjuhën shqipe në përputhje me moshën.)
- 1 Vështirësi e lehtë/pak vështirësi** do të thotë se fëmija has pak vështirësi herë pas here, por këto vështirësi nuk e bëjnë të pamundur kryerjen e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësi shkakton vetëm kufizime të vogla në pjesëmarrje që nuk janë të ndjeshme në cilësinë e jetës së fëmijës. (p.sh. fëmijës i mbahet goja kur flet, por kjo nuk krijon pengesa në komunikim me të tjerët.)
- 2 Vështirësi e moderuar** do të thotë se fëmija has disa pengesa në realizimin e veprimit, por këto pengesa nuk e bëjnë të pamundur kryerjen e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësi shkakton kufizime të konsiderueshme në pjesëmarrje që janë të ndjeshme në cilësinë e jetës së fëmijës. (p.sh. fëmija ka një fjalor të kufizuar dhe përdor vetëm fjali të thjeshta në komunikim)
- 3 Vështirësi e rëndë/shumë vështirësi** do të thotë se fëmija has shumë vështirësi në realizimin e veprimit në masë të tillë që në shumicën e rasteve e ka pothuaj të pamundur realizimin e aktivitetit. Kjo shkallë vështirësi shkakton kufizime të mëdha në pjesëmarrje që ndikojnë në shpëputjen e pjesshme të fëmijës nga jeta e përditshme. (p.sh. fëmija mund të kuptojë fjalë e shprehje nga gjuha e folur dhe mund të thotë disa fjalë apo edhe ndonjë fjali, por e ka të pamundur të shprehë mendimet.)
- 4 Vështirësi e thellë/e plotë** do të thotë se fëmija has vështirësi të tilla që nuk e lejonë në asnjë mënyrë realizimin e veprimit. Kjo shkallë vështirësi e shpëput plotësisht fëmijën nga jeta e përditshme dhe pjesëmarrja. (p.sh. fëmija mund të kuptojë ndonjë fjalë, por nuk shprehet.)

Kufizimet në aktivitetet dhe pjesëmarrjen

Niveli i vështirësisë

0	1	2	3	4
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

11. Ka ndonjë faktor tjetër, i cili nuk është adresuar në pyetjet më lart, për të cilin ju besoni që mund të ndikojë në aftësinë e fëmijës, për të funksionuar normalisht në jetën e përditshme, në përputhje me kërkesat e moshës?

Po Jo

(Nëse po, specifikoj)

12. Duke u bazuar në mendimin tuaj profesional, analizat dhe testet që ka kryer fëmija, të dokumentuara në dosjen e tij/saj në klinikën tuaj, a e rekomandoni këtë person për të marrë mendimin e mjekut specialist për përfitimin e aftësisë së kufizuar?

Po Jo

13. Nëse po, cilin specialitet rekomandoni (p.sh. mjek neurolog, etj)?

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit Nr. 9887 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" të ndryshuar, autorizoj me vullnetim tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar

